

Thirrje për kompani të komunikimit multimedial për të realizuar tri videove të shkurta vetëdijësuese për OJQ Balkan Sunflowers Kosova (BSFK) të financuar nga UNICEF.

TERMAT E REFERENCËS

Funksioni: Realizimi i tri videove të shkurta

Lokacioni: Kosovë

Përmbledhje

Si rezultat i pandemisë COVID19, institucionet e Kosovës filluan implementimin e masave për parandalimin dhe mbrojtjen nga COVID-19.

Përqindja e imunizimit të fëmijëve nga komunitetet Ashkali, Egjiptjan dhe Rom e cila ishte e ulët edhe para pandemisë, është ulur edhe më shumë që nga fillimi i pandemisë.

Gjate kësaj periudhe, institucionet shëndetësore kanë drejtuar resurset ekzistuese kryesisht në luftën kundër Coronavirusit dhe imunizimi i fëmijëve nuk është kryer sipas kalendarit të vaksinimit. Poashtu, për shkak të frikës nga infektimi nga Coronavirusi, por në disa raste edhe vetëdijësimit të ulët për imunizim, prindërit e këtyre fëmijëve nuk kanë dërguar fëmijët për imunizim sipas kalendarit të rregullt të imunizimit.

Balkan Sunflowers Kosova (BSFK) është duke implementuar projektin e financuar nga Zyra e UNICEF në Kosovë i cili ka për qëllim kryesor rritjen e ndërgjegjësimit dhe imunizimin e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë. Projekti realizohet në 6 komuna të Kosovës: Fushë Kosovë, Shtime, Obiliq, Gjilan, Ferizaj dhe Lipjan.

Në kuader të projektit, BSFK është duke implementuar një hulumtim për të mbledhur informata për situatën e imunizimit të fëmijëve të moshës 0-7 në 6 komuna, në baze të të cilit BSFK do të strukturojë një databazë me informata për fëmijët që kanë nevojë të imunizohen. Databaza do të ofrohet institucioneve përgjegjëse.

BSFK do të asistojë institucionet shëndetësore në imunizimin e fëmijëve përmes vullnetarëve në terren. Vullnetarët e BSFK do të vizitojnë familjet nga këto tri komunitete me qëllim të rritjes së vetëdijësimit për rëndësinë e imunizimit.

Objektivi:

Objektivi kryesor i tri videove të synuara përmes thirrjes është rritja e vetëdijësimit të komuniteteve Ashkali, Egjiptjan dhe Rom në Kosovë për rëndësinë e imunizimit.

Qëllimi i punës:

Kompania e perzgjedhur do te:

- krijojë, modifikojë dhe shtojë kontekstin lokal,
- Redaktoj pamjet në përputhje me skenarin e dakorduar dhe aprovuar nga BSFK dhe te prodhoj një paketë të cilësisë së transmetimit
- te vendos titrat në gjuhën angleze dhe gjuhën serbe dhe muzikën në video (videot duhet të posedojnë përkthimet në tri gjuhët), me qëllim që të përcjellë dhe përfaqësojë qëllimin për rritjen e vetëdijësimit për rëndësinë e imunizimit.
- Te regjistroj dhe redaktoj narracionin / zërin atje ku është e nevojshme në përputhje me udhëzimet nga BSFK
- Te vendose nën-titujt në video sipas nevojës
- Te balancoje audio produktin përfundimtar dhe shndërrimin i tij në formate për përdorim në TV, radio, web
- Te identifikoj qartë vendndodhjen, emrin dhe moshën e të intervistuarve, citatat dhe të gjitha detajet përkatëse.

Videot duhet te zhvillohen ne menyre qe te përfshijnë fragmente të punës së vullnetarëve në teren, aktivitete të realizimit të imunizimit në teren apo institucione shëndetësore, deklarata nga përfituesit (prindërit e fëmijëve), dhe/ose elemente te tjera te paraqitura ne skenaret e propozuara nga zhvilluesi

Shënim: Kompania duhet të ketë kujdes të veçantë ne rast te ekspozimit të fëmijëve në video. Dokumenti i nënshkruar nga prindi apo kujdestari duhet të kërkohet paraprakisht.

Kompania duhet:

- Të jetë një biznes i regjistruar në Kosovë;
- Të ketë përvojë minimale prej tre vjetësh në krijimin e videove dhe në shërbime të tjera multimediale;
- Përvoja e mëparshme e punës me organizatat joqeveritare, agjencitë ndërkombëtare konsiderohet përparësi
- Të koordinojë zhvillimin e videos me BSFK dhe ta konsiderojë finale pas aprovimit te BSFK.

Kompanitë e interesuara duhet të dërgojnë këto dokumente:

- Historiku i shkurtër i kompanisë (CV).
- Konfirmimi i regjistrimit te kompanisë.
- Shembuj nga materialet apo videot e zhvilluara.
- Skenaret e propozuara për tri videot.
- Propozimi teknik i videos të propozuar (specifikacionet për pajisjet, mjetet e punës);
- Çimimi I ofertes.

Produkti: Tri video ne gjatesi 60-90 sekonda për rritjen e vetëdijësimit për rëndësinë e imunizimit.

Kushtet e përgjithshme

Produkti:

- 3 video me cilësi të lartë të cilat plotësojnë kushtet e cekura në terma të referencës.

Afati i fundit:

Kompanitë e interesuara duhet të dërgojnë dokumentet e tyre të aplikimit (të përmendura më lartë) në emailin: applications@balkansunflowers.org

Afati i fundit për dërgimin e ofertave është 14 Nëntor 2020 ora 15:00

Për çdo pyetje teknike që lidhet me kërkesën tuaj, ju lutemi na kontaktoni në:

office@balkansunflowers.org